

LIGJ
Nr. 4/2025

**PËR RATIFIKIMIN E VENDIMIT NR. 2/2024 TË KOMITETIT TË PËRBASHKËT
TË KONVENTËS RAJONALE PËR RREGULLAT PREFERENCIALE TË ORIGJINËS
PAN-EURO-MEDITERIANE TË 12 DHJETORIT 2024 PËR NDRYSHIMIN E
VENDIMIT NR. 1/2023 TË KOMITETIT TË PËRBASHKËT, MIRATUAR ME LIGJIN
NR. 59/2024, ME QËLLIM PËRFSHIRJEN E DISPOZITAVE KALIMTARE NË
NDRYSHIMET E KONVENTËS RAJONALE PËR RREGULLAT PREFERENCIALE TË
ORIGJINËS PAN-EURO-MEDITERIANE, TË ZBATUESHME NGA 1 JANARI 2025**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pikat 1 e 2, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet vendimi nr. 2/2024 i Komitetit të Përbashkët të Konventës Rajonale për Rregullat Preferenciale të Origjinës Pan-Euro-Mediterrane të 12 dhjetorit 2024 për ndryshimin e vendimit nr. 1/2023 të Komitetit të Përbashkët, miratuar me ligjin nr. 59/2024, me qëllim përfshirjen e dispozitave kalimtare në ndryshimet e Konventës Rajonale për Rregullat Preferenciale të Origjinës Pan-Euro-Mediterrane, të zbatueshme nga 1 janari 2025, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2025.

Miratuar në datën 30.1.2025.

Shpallur me dekretin nr. 30, datë 13.2.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

VENDIM NR. 2/2024

I KOMITETIT TË PËRBASHKËT TË KONVENTËS RAJONALE PËR RREGULLAT
PREFERENCIALE TË ORIGJINËS PAN-EURO-MEDITERIANE
i 12 dhjetorit 2024

**për ndryshimin e vendimit nr. 1/2023 të Komitetit të Përbashkët me qëllim përfshirjen e
dispozitave kalimtare në ndryshimet e Konventës Rajonale për Rregullat Preferenciale të
Origjinës Pan-Euro-Mediterrane, të zbatueshme nga 1 janari 2025**

KOMITETI I PËRBASHKËT,

Pas shqyrtimit të Konventës Rajonale për rregullat preferenciale të origjinës pan-euro-mediterrane¹ dhe, në veçanti, nenit 4(1) dhe nenit 4(3) pika (a) të saj,

Duke marrë parasysh se:

1. Palët Kontraktuese të Konventës Rajonale për Rregullat Preferenciale të Origjinës Pan-Euro-Mediterrane (Konventa) ranë dakord për ndryshimin e Konventës, me qëllim ofrimin e një grupi të ri

¹ FZ e BE L 54, 26.2.2013, f. 4.

rregullash të modernizuara dhe më fleksibël të origjinës. Vendimi nr. 1/2023¹ i Komitetit të Përbashkët për ndryshimin e Konventës që përcakton rregullat e rishikuara të origjinës, u miratua më 7 dhjetor 2023 dhe do të hyjë në fuqi më 1 janar 2025 (rregullat e rishikuara të Konventës).

2. Palët Kontraktuese bien dakord se dispozitat kalimtare janë të nevojshme për të sqaruar trajtimin preferencial që do t'u jepet mallrave të eksportuara nga një Palë Kontraktuese para hyrjes në fuqi të rregullave të rishikuara të Konventës dhe më pas të importuara te një Palë tjetër Kontraktuese mbas hyrjes në fuqi të këtyre rregullave.

3. Provat e origjinës të lëshuara ose të përgatitura para datës 1 janar 2025 në një Palë Kontraktuese në përputhje me rregullat për zbatimin opsional të Konventës, deri në përfundimin dhe hyrjen në fuqi të rregullave të rishikuara të Konventës duhet të pranohen për trajtim preferencial në import pas datës 1 janar 2025.

4. Provat e origjinës të lëshuara ose të përgatitura në përputhje me shtojcën I të Konventës, apo të lëshuara sipas protokolleve që lidhen me konceptin e “produkteve origjinuese” dhe metodat e bashkëpunimit administrativ që i paraprijnë Konventës, para datës së hyrjes në fuqi të ndryshimeve në protokollat dypalëshe ndërmjet Palëve Kontraktuese, për të përfshirë referencën në Konventën e ndryshuar së fundmi, duhet të pranohen për trajtim preferencial në import, pas asaj date.

5. Një numër Palësh Kontraktuese kanë njoftuar se nuk do të jenë në gjendje të përditësojnë protokollat e tyre dypalëshe mbi rregullat e origjinës, me referencë në Konventën e ndryshuar së fundmi, para datës 1 janar 2025, për shkak të kohëzgjatjes që kërkojnë procedurat e tyre të brendshme.

6. Vonesa në përditësimin e protokolleve dypalëshe nga një numër Palësh Kontraktuese, për të përfshirë referencë në Konventën e ndryshuar së fundmi, mund të shkaktojë ndërprerjen e mundësive aktuale të kumulimit.

7. Palët Kontraktuese bien dakord se janë të nevojshme dispozita kalimtare për të ruajtur flukset tregtare, të bazuara në mundësitë aktuale të kumulimit, derisa të përfundojë procesi i përafrimit të të gjitha protokolleve dypalëshe me referencë ndaj Konventës së ndryshuar së fundmi. Shtojca I e Konventës, e zbatueshme para ndryshimeve të bëra me vendimin nr. 1/2023 të Komitetit të Përbashkët, duhet të zbatohen si masa kalimtare ndërmjet Palëve Kontraktuese të Konventës, paralelisht me rregullat e rishikuara të Konventës, si dhe kumulimi duhet të lejohet ndërmjet grupeve të ndryshme të rregullave, aty ku të jetë e mundur.

8. Palët Kontraktuese bien dakord që dispozitat kalimtare të kenë natyrë teknike dhe duhet të zbatohen sa më shpejt të jetë e mundur. Aty ku bëhet e mundur, duhet të garantohet zbatimi i përkohshëm i dispozitave kalimtare sipas legjislacionit të brendshëm të Palëve Kontraktuese.

9. Palët Kontraktuese bien dakord të ndryshojnë vendimin nr. 1/2023 të Komitetit të Përbashkët, për të përfshirë në rregullat e rishikuara të Konventës dispozitat kalimtare të zbatueshme për një periudhë njëvjeçare, nga data e hyrjes në fuqi e rregullave të rishikuara të Konventës, konkretisht për periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2025.

10. Çdo Palë Kontraktuese duhet të marrë masa të përshtatshme për të garantuar që rregullat e rishikuara të Konventës të zbatohen në mënyrë efektive, duke përafruar protokollat dypalëshe me referencë ndaj Konventës së ndryshuar së fundmi, deri më 31 dhjetor 2025.

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

1. Vendimi nr. 1/2023 do të ndryshohet sipas parashikimeve në aneksin e këtij vendimi.
2. Ndryshimet e vendimit nr. 1/2023 do të hyjnë në fuqi më 1 janar 2025.

Neni 2

Ky vendim do të hyjë në fuqi në datën e miratimit të tij.

Bërë në Bruksel, 12 dhjetor 2024.

¹ FZ e BE L, 2024/390, 19.2.2024, ELI: <https://eur-lex.europa.eu/eli/dec/2024/390/oj>.

Për Komitetin e Përbashkët:
KRYETARI
Maria Isabel Garcia Catalan

ANEKS

Neni i vetëm

Ndryshimi i vendimit nr. 1/2023 të Komitetit të Përbashkët të Konventës Rajonale për Rregullat Preferenciale të Origjinës Pan-Euro-Mediterrane

Në vendimin nr. 1/2023 të Komitetit të Përbashkët të Konventës Rajonale për Rregullat Preferenciale të Origjinës Pan-Euro-Mediterrane të datës 7 dhjetor 2023 mbi ndryshimin e Konventës Rajonale për Rregullat Preferenciale të Origjinës Pan-Euro-Mediterrane, neni i vetëm i aneksit të mëposhtëm ndryshohet si më poshtë:

1. Në pikën (5), neni i mëposhtëm i shtohet shtojcës I:
“Neni 42 Dispozitat kalimtare

1. Shtojca I e Konventës, e publikuar në FZ të BE L54/4, të datës 26 shkurt 2013, do të zbatohet ndërmjet Palëve Kontraktuese të Konventës deri më 31 dhjetor 2025, paralelisht me këtë shtojcë.

2. Provat e origjinës, të lëshuara ose të përgatitura para 1 janarit 2025, në përputhje me rregullat për zbatimin opsional në Konventë deri në përfundimin dhe hyrjen në fuqi të ndryshimit të Konventës (“Rregullat kalimtare të origjinës”) dhe të paraqitura pas asaj date, brenda periudhës së tyre të vlefshmërisë, do të pranohen për trajtim preferencial në import për mallrat që në 1 janar 2025 janë ose në transit, ose të vendosura sipas një procedure të veçantë nën kontrollin doganor. Këto mallra mund të përdoren për kumulim, siç parashikohet në nenin 7.

3. Në rastet e paraqitjes së vonuar të provave të origjinës të lëshuara ose të përgatitura para datës 1 janar 2025 në përputhje me Rregullat kalimtare të origjinës, do të zbatohet neni 23 (2) dhe (3) për mallrat e përmendura në paragrafin 2 të këtij neni.

4. Provat e origjinës të lëshuara apo të përgatitura në përputhje me shtojcën I të Konventës së publikuar në Fletoren Zyrtare të BE L54/4, datë 26 shkurt 2013, ose të lëshuara në përputhje me rregullat e origjinës të përfshira në protokollin që i paraprijnë Konventës para datës së hyrjes në fuqi të ndryshimit të protokolleve dypalëshe ndërmjet Palëve Kontraktuese për të përfshirë referencën në Konventën e ndryshuar së fundmi, dhe të paraqitura pas asaj date, do të pranohen brenda periudhës së tyre të vlefshmërisë për trajtim preferencial në import për mallrat që në atë datë janë ose në transit, ose të vendosura sipas një procedure të veçantë nën kontrollin doganor. Në rastet e paraqitjes së vonuar të këtyre provave, do të zbatohet neni 23, (2) dhe (3).

5. Provat e origjinës të lëshuara apo të përgatitura para 1 janarit 2026 në përputhje me paragrafin 1 ose me rregullat e origjinës, të përfshira në protokollin që i paraprijnë Konventës dhe të paraqitura pas kësaj date brenda periudhës së tyre të vlefshmërisë, do të pranohen për trajtim preferencial në import për mallrat që më 1 janar 2026 janë ose në transit, ose të vendosura sipas një procedure të veçantë nën kontrollin doganor. Në rastet e paraqitjes së vonuar të këtyre provave, do të zbatohet neni 23, (2) dhe (3).

6. Për qëllim verifikimi, neni 33 (2), neni 34 dhe kur gjen zbatim, neni 35, do të zbatohen gjithashtu për provat e origjinës të lëshuara ose të përgatitura në përputhje me Rregullat kalimtare të origjinës dhe provat e origjinës të lëshuara ose të përgatitura sipas protokolleve që i paraprijnë Konventës, të zbatueshme para 1 janarit 2025.

7. Për qëllim verifikimi, neni 33 (2) dhe neni 34 do të zbatohen gjithashtu, nëse kërkesa për verifikim paraqitet pas datës 1 janar 2026 ose pas datës së hyrjes në fuqi të ndryshimit të protokolleve dypalëshe ndërmjet Palëve Kontraktuese për të përfshirë referencën në Konventën e ndryshuar së fundmi, për provat e origjinës të lëshuara ose të përgatitura në përputhje me shtojcën I të Konventës së publikuar në Fletoren Zyrtare të BE L54/4, datë 26 shkurt 2013 dhe Protokollin që i paraprijnë Konventës.

8. Palët Kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën çdo katër muaj nëpërmjet Komisionit Evropian mbi statusin e përditësimit të protokolleve të tyre dypalëshe, me qëllim përfshirjen e referencës në Konventën e ndryshuar së fundmi dhe masat e marra për të garantuar që rregullat e Konventës të ndryshuar me vendimin nr. 1/2023 të Komitetit të Përbashkët zbatohen në mënyrë efektive nga 1 janari 2026.

9. Certifikatat e qarkullimit EUR.1 të lëshuara në përputhje me këtë shtojcë do të përmbajnë deklaratën në anglisht ‘RREGULLAT E RISHIKUARA – REVISED RULES’ në kutinë 7. Ajo deklaratë do të shtohet gjithashtu në fund të tekstit të deklaratës së origjinës, të përgatitur në përputhje me këtë shtojcë. Deklarata do të përfshihet në provat e origjinës deri më 31 dhjetor 2025.”

2. Në pikën (5), paragrafi i mëposhtëm shtohet në nenin 8 në shtojcën I.

“1a. Kumulimi i parashikuar në nenin 7 mund të zbatohet për mallrat e klasifikuara nën kapitujt 1, 3, 16 (për produktet e përpunuara të peshkimit) dhe 25 deri 97 të Sistemit të Harmonizuar që kanë fituar status origjinues, nëpërmjet zbatimit të rregullave të origjinës sipas nenit 42 (1) dhe dispozitat përkatëse të shtojcës II, si dhe nëpërmjet zbatimit të rregullave të origjinës të përfshira në protokollin që lidhen me përkufizimin e konceptit të ‘produkteve origjinuese’ dhe metodat e bashkëpunimit administrativ që i paraprijnë Konventës, për sa kohë që materialet dhe produktet janë origjinuese në Palët Kontraktuese, për të cilat kumulimi është i mundshëm, siç është njoftuar në “Njoftimin e Komisionit për zbatimin e Konventës Rajonale për Rregullat Preferenciale të Origjinës Pan-Euro-Mediterrane ose protokolleve mbi rregullat e origjinës që parashikojnë kumulimin diagonal ndërmjet Palëve Kontraktuese të kësaj Konvente”, siç është publikuar së fundmi në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Ky paragraf do të zbatohet për periudhën e parashikuar në nenin 31, (1) për mallrat e mbuluara nga provat e originës të përmendura në nenin 42, (4) dhe (5).”

DECISION No 2/2024
OF THE JOINT COMMITTEE OF THE REGIONAL CONVENTION
ON PAN-EURO-MEDITERRANEAN PREFERENTIAL RULES OF ORIGIN

of 12 December 2024

amending Decision No 1/2023 of the Joint Committee
in order to include transitional provisions
in the amendments of the Regional Convention on pan-Euro-Mediterranean
preferential rules of origin applicable as of 1 January 2025

THE JOINT COMMITTEE,

Having regard to the Regional Convention on pan-Euro-Mediterranean preferential rules of origin¹
and in particular to Article 4(1) and Article 4(3), point (a), thereof,

¹ OJ EU L 54, 26.2.2013, p. 4.

Whereas:

- (1) The Contracting Parties to the Regional Convention on pan-Euro-Mediterranean preferential rules of origin (the ‘Convention’) agreed on the amendment of the Convention in order to provide for a new set of modernised and more flexible rules of origin. Decision No 1/2023² of the Joint Committee on the amendment of the Convention, which sets out revised rules of origin, was adopted on 7 December 2023 and will enter into force on 1 January 2025 (the ‘revised rules of the Convention’).
- (2) The Contracting Parties agree that transitional provisions are needed to clarify the preferential treatment to be granted for goods exported from a Contracting Party before the entry into force of the revised rules of the Convention and imported in another Contracting Party after the entry into force of those rules.
- (3) Proofs of origin issued or made out before 1 January 2025 in a Contracting Party in accordance with the rules for optional application to the Convention pending the conclusion and entry into force of the revised rules of the Convention should be accepted for preferential treatment at importation after 1 January 2025.
- (4) Proofs of origin issued or made out in accordance with Appendix I to the Convention, or issued in accordance with the protocols concerning the definition of the concept of ‘originating products’ and methods of administrative cooperation preceding the Convention, before the date of entry into force of the amendment of the bilateral protocols between the Contracting Parties to include the reference to the Convention as last amended should be accepted for preferential treatment at importation after that date.

² OJ EU L, 2024/390, 19.2.2024, ELI: <https://eur-lex.europa.eu/eli/dec/2024/390/oj>.

- (5) A number of the Contracting Parties have indicated that they will not be in a position to update, before 1 January 2025, their bilateral protocols on rules of origin with a reference to the Convention as last amended, due to the length of their internal procedures.
- (6) The delay by a number of Contracting Parties in updating the bilateral protocols to include a reference to the Convention as last amended could lead to the disruption of current cumulation possibilities.
- (7) The Contracting Parties agree that transitional provisions are needed to preserve trade flows based on current cumulation possibilities, pending the finalisation of the process of aligning all bilateral protocols with a reference to the Convention as last amended. Appendix I to the Convention as applicable prior to the amendments introduced by Decision No 1/2023 of the Joint Committee should be applicable, as a transitional measure, between the Contracting Parties to the Convention in parallel with the revised rules of the Convention and cumulation should be allowed between the different sets of rules where possible.
- (8) The Contracting Parties agree that the transitional provisions are technical in nature and should be applied as soon as possible. Where possible under the Contracting Parties' internal legislation, the provisional application of the transitional provisions should be ensured.
- (9) The Contracting Parties agree to amend Decision No 1/2023 of the Joint Committee to include in the revised rules of the Convention transitional provisions applicable for a period of one year from the date of entry into force of the revised rules of the Convention, namely for the period from 1 January to 31 December 2025.
- (10) Each Contracting Party should take appropriate measures to ensure that the revised rules of the Convention are effectively applied by aligning the bilateral protocols with a reference to the Convention as last amended by 31 December 2025,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

1. Decision No 1/2023 shall be amended as set out in the Annex to this Decision.
2. The amendments to Decision No 1/2023 shall enter into force on 1 January 2025.


Article 2

This Decision shall enter into force on the date of its adoption.

Done at Brussels, 12 December 2024

For the Joint Committee

The Chair

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Isabel Garcia', with a stylized flourish at the end.

Maria Isabel GARCIA CATALAN

ANNEX

Sole Article

Amendment of Decision No 1/2023 of the Joint Committee of the Regional Convention on pan-Euro-Mediterranean preferential rules of origin

In Decision No 1/2023 of the Joint Committee of the Regional Convention on pan-Euro-Mediterranean preferential rules of origin of 7 December 2023 on the amendment of the Regional Convention on pan-Euro-Mediterranean preferential rules of origin, the Sole Article of the Annex thereto is amended as follows:

1. in point (5), the following article is added to Appendix I:

‘Article

42

Transitional provisions

1. Appendix I to the Convention as published in OJ EU L 54/4 of 26 February 2013 shall be applicable between the Contracting Parties to the Convention until 31 December 2025 in parallel with this Appendix.
2. Proofs of origin issued or made out before 1 January 2025 in accordance with the rules for optional application to the Convention pending the conclusion and entry into force of the amendment of the Convention (the “Transitional rules of origin”) and submitted after that date, within their validity period, shall be accepted for preferential treatment at importation for goods which, on 1 January 2025, are either in transit or placed under a special procedure under customs control. Those goods may be used for cumulation as provided for in Article 7.
3. In cases of belated presentation of proofs of origin issued or made out before 1 January 2025 in accordance with the Transitional rules of origin, Article 23(2) and (3) shall apply to the goods mentioned in paragraph 2 of this Article.
4. Proofs of origin issued or made out in accordance with Appendix I to the Convention as published in OJ EU L 54/4 of 26 February 2013 or issued in accordance with the rules of origin contained in the protocols preceding the Convention before the date of entry into force of the amendment of the bilateral protocols between the Contracting Parties to include the reference to the Convention as last amended, and submitted after that date, shall be accepted within their validity period for preferential treatment at importation for goods which, on that date, are either in transit or placed under a special procedure under customs control. In cases of belated presentation of such proofs, Article 23(2) and (3) shall apply.

5. Proofs of origin issued or made out before 1 January 2026 in accordance with paragraph 1 or in accordance with the rules of origin contained in the protocols preceding the Convention and submitted after that date, within their validity period, shall be accepted for preferential treatment at importation for goods which, on 1 January 2026, are either in transit or placed under a special procedure under customs control. In cases of belated presentation of such proofs, Article 23(2) and (3) shall apply.
6. For the purpose of verification, Article 33(2), Article 34 and, where applicable, Article 35 shall also apply to proofs of origin issued or made out in accordance with the Transitional rules of origin and proofs of origin issued or made out according to the protocols preceding the Convention applicable before 1 January 2025.
7. For the purpose of verification, Article 33(2) and Article 34 shall also apply if the verification request is submitted after 1 January 2026 or after the date of entry into force of the amendment of the bilateral protocols between the Contracting Parties to include the reference to the Convention as last amended, for proofs of origin issued or made out in accordance with Appendix I to the Convention as published in OJ EU L 54/4 of 26 February 2013 and the protocols preceding the Convention.
8. The Contracting Parties shall notify each other every four months, through the European Commission, of the state of play in updating their bilateral protocols to include the reference to the Convention as last amended and of the measures taken to ensure that the rules of the Convention as amended by Decision No 1/2023 of the Joint Committee are effectively applied from 1 January 2026.

9. The movement certificates EUR.1 issued in accordance with this Appendix shall include the statement in English “REVISED RULES” in box 7. That statement shall also be added at the end of the text of the origin declaration made out in accordance with this Appendix. That statement shall be included in the proofs of origin until 31 December 2025.’;
2. in point (5), the following paragraph is inserted in Article 8 in Appendix I:
- ‘1a. The cumulation provided for in Article 7 may be applied for goods classified under Chapters 1, 3, 16 (for processed fishery products) and 25 to 97 of the Harmonised System that have obtained originating status by the application of the rules of origin under Article 42(1) and the relevant provisions of Appendix II as well as by the application of the rules of origin included in the protocols concerning the definition of the concept of “originating products” and methods of administrative cooperation preceding the Convention provided that materials and products are originating in the Contracting Parties for which cumulation is possible, as notified in the “Commission notice concerning the application of the Regional Convention on pan-Euro-Mediterranean preferential rules of origin or the protocols on rules of origin providing for diagonal cumulation between the Contracting Parties to this Convention”, as last published in the *Official Journal of the European Union*.
- This paragraph shall apply for the period provided in Article 31(1) to goods covered by the proofs of origin mentioned in Article 42(4) and (5).’.
-